

Vendim nr. 49 datë 02.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese
Marjana Semini, Anëtare
Sandër Beci, Anëtar

në datën 02.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (K) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KURT RUSI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 1, datë 29.07.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimi për gjykim i kërkesës së datës 30.05.2022.**

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, pika 2 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1 dhe 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kallëzimit të kërkuarit Kurt Rusi, i datëlindjes 1952, në cilësinë e viktimës së veprës penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 958, datë 29.01.2019, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të

parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimit, prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes penale.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4009 akti, datë 11.12.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e çështjes penale. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuar, i cili është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr. 3247, datë 13.01.2020. Mbi bazën e rishortimit të datës 12.05.2022, çështja i është caktuar për shqyrtim një gjyqtari tjetër.

3. Në datën 27.05.2022, për shkak të kalimit të afatit 15-ditor të parashikuar në pikën 7 të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), kërkuar ka dërguar kërkesë në Gjykatën e Apelit Tiranë, drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për gjykimin e ankimit. Kërkesa është dorëzuar në gjykatë në datën 30.05.2022 dhe më pas është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 1 akti, datë 14.07.2022.

4. Gjatë kohës që pritej regjistrimi i kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 693, datë 13.07.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 4009 akti, datë 11.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 1, datë 29.07.2022, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes nr. 1 akti, datë 14.07.2022, me arsyetimin se çështja ka mbetur pa objekt, pasi Gjykata e Apelit Tiranë ishte shprehur tashmë me vendim.

6. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në datën 07.12.2022, me ankim kushtetues individual, të regjistruar në datën 21.12.2022, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 1, datë 29.07.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe kthimin për gjykim të kërkesës së datës 30.05.2022.

II

Pretendimet e kërkuar

7. Kërkuar, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtat për gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e paanshme, si dhe shpërblim të drejtë, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës, pasi ajo ka interpretuar gabim ligjin, duke u shprehur vetëm për përshpejtimin e procedurave dhe jo për

konstatimin e vonesës, në kushtet kur afati për shqyrtimin e kërkesës fillonte nga data e paraqitjes së saj në gjykatë, më 30.05.2022.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

9. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e viktimës nga vepra penale ka vënë në lëvizje me kallëzim procedimin penal, për pushimin e të cilit ka ngritur pretendime në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë provon interesin e tij në çështjen e parashtruar.

11. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuuesi ka shteruar

të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

12. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka përcjellë me vonesë, përtej afatit ligjor 15-ditor, në Gjykatën e Lartë kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, pasi ai e ka paraqitur atë në datën 30.05.2022 dhe ajo është regjistruar në datën 14.07.2022. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk është shprehur në vendim lidhur me konstatimin e vonesës, duke i mohuar atij të drejtën për kërkimin e shpërblimit të dëmit, të garantuar nga neni 399/6, pika 3, i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

13. Kolegji vëren se në datën 13.01.2020 në Gjykatën e Apelit Tiranë është regjistruar ankimi i kërkuesit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë që kishte lënë në fuqi vendimmarrjen e prokurorit për pushimin e çështjes penale të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të tij. Ankimi pas rishortimit, në datën 12.05.2022, i kaloi për shqyrtim një gjyqtari tjetër, i cili u shpreh me vendim 2 muaj më vonë, në datën 13.07.2022. Gjatë kësaj kohe, në datën 30.05.2022, kur kishin kaluar rreth 18 ditë nga rishortimi i ankimit, kërkuesi, bazuar në nenet 399/1, 399/2, 399/5, 399/6 dhe 399/7, pika 2, të KPC-së, ka paraqitur kërkesë në gjykatën e apelit drejtuar Gjykatës së Lartë, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të ankimit të tij. Kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 14.07.2022, e cila disponoi me vendim në datën 29.07.2022.

14. Lidhur me afatin e shqyrtimit të ankimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka përfshirë informacionin e dhënë nga gjyqtari relator i çështjes i caktuar pas rishortimit, i cili ka deklaruar se në datën 04.09.2020, me vendim të Këshillit të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur shkrirja e seksioneve (civile dhe penale) dhe e gjithë trupa do të shqyrtonte çështje civile, penale, masa sigurimi, duke iu dhënë prioritet çështjeve penale me të arrestuar, ndërsa çështjet e tjera, përfshirë këtu edhe ato me afate procedurale të përcaktuara në ligj, janë marrë për shqyrtim sipas radhës së regjistrimit nga më i vjetri. Sipas tij, duke iu referuar kategorisë së kësaj çështje dhe afateve të ngutshme të gjykimit sipas nenit 329 të KPP-së, ajo është planifikuar në mënyrë të përshpejtuar, pra jashtë radhe, për t'u zhvilluar në datën 13.07.2022, ora 12:30 (*shih paragrafin 5 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

15. Në kontekst të rrethanave të sipërcituara, Kolegji sjell në vëmendje se ligji procedural civil ka parashikuar mjetet për t'i garantuar individit mbrojtjen efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 16,*

datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Qëllimi i mjeteve të përcaktuara nga nenet 399/1 e në vijim të KPC-së është parandalimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes dhe shpërblimi i drejtë për shkak të kësaj kohëzgjatjeje. Dispozitat e KPC-së kanë përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Sipas nenit 399/3 të KPC-së, shpërblim i drejtë konsiderohet njohja e shkeljes, masat e marra për përshpejtimin e procedurave dhe/ose shpërblimi i dëmit, i përcaktuar në vlerë monetare në nenin 399/10 të këtij kodi.

16. Këto mjete juridike synojnë të mbrojnë të drejtën e individit për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave të hetimit, të gjykimit të çështjeve (civile, penale ose administrative) dhe të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, si dhe shpërblimin e drejtë për këtë shkak. Në këtë kuptim, këto mjete janë instrumente në dispozicion të individit dhe, si të tilla, nuk përbëjnë proces autonom nga ai i gjykimit të themelit të çështjes, i cili të gëzojë, për këtë shkak, edhe mbrojtje autonome të garancive të nenit 42 të Kushtetutës. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë do të humbiste kuptimi i natyrës përfundimtare të gjykimit kushtetues të ankesave individuale. Parë në këtë këndvështrim, ankimi kushtetues synon të mbrojë të drejtën për proces të rregullt pikërisht gjatë procedurave si më sipër, ndërkohë që procedurat e shqyrtimit të kërkesave për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së mund të vlerësohen nga Gjykata Kushtetuese vetëm në drejtim të efektivitetit të këtyre mjeteve procedurale.

17. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi procesi dhe vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej kërkuarit nuk përbëjnë gjykim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Në këtë pikë, Kolegji evidenton se kërkuari ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të ankimit të tij nga Gjykata e Apelit Tiranë, që, siç u theksua edhe më lart, përbën një instrument në dispozicion të tij për të parandaluar shkeljen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të ankimit kundër pushimit të procedimit penal, që ai pretendon se është viktimë. Ky instrument i përdorur prej kërkuarit, në thelb, ka rezultuar efektiv, pasi Gjykata e Apelit e Tiranë ka përfunduar shqyrtimin e ankimit me vendimin nr. 693, datë 13.07.2022.

18. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.